

## Edukimi për të drejtat e njeriut në shkolla fillore

OSBE-ja ndihmon Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në aplikimin e mësimit për të drejtat e njeriut në lëndën e edukatës qytetare.

**Nikola Gaon, OSBE**

***Ndërtimi i institucioneve demokratike, si dhe mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut janë detyra kryesore të misionit të OSBE-së në Kosovë (shtylla e III e administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara).***

Këto detyra shpesh përceptohen si diçka që kanë të bëjnë me politikën ose vetëm politikanët, por janë njerëzit e thjeshtë ata që e përbëjnë shoqërinë dhe e përcaktojnë kualitetin e saj. Me fjalë tjera, politikanët dhe politika, edhe pse shumë të rëndësishëm, nuk mund ta krijojnë vet një shoqëri demokratike që përkrah të drejtat e njeriut. Këto vlera duhet të përqafohen nga qytetarët e thjeshtë. Përveç kësaj, për të krijuar një kulturë të mirëfilltë të të drejtave të njeriut, është e domosdoshme që të gjithë të mësojnë ta përdorin ligjin për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Prandaj, në vend që të përqafohen këto vlera në moshë më të shtyer, të drejtat e njeriut dhe demokracia mund të kuptohen më së miri në moshën e re. Në fakt, mësimi për të drejtat e njeriut mund të fillojë të aplikohet në qendrat parashkollore dhe duhet të vazh-



*Edukimi për të drejtat e njeriut ka filluar të aplikohet në klasët e gjashta të shkollës fillore. Pala ndërkombëtare rekomandon që të aplikohet në të gjitha nivelet duke filluar nga arsimit fillor dhe ai i lartë.*

### NË KËTË NUMËR

**Qendra Juridike e Kosovës edukon të rinjtë** fq. 3

**Vetëdijësi politike e të rinjëve në Kaçanik** fq. 6

**Kampi veror Liderët e Ardhshëm 2005** fq. 9

**Nga zyra e OSBE-së në Gjilan** fq. 11-16

dojë gjatë shkollës fillore, të mesme si dhe gjatë arsimit të lartë.

Sistemi arsimor i Kosovës dhe planprogrami i hartuar pas konfliktit të vitit 1999 dhe vendosjes së administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara ka qenë më i përparuar nga ai i ish-Jugosllavisë. Sidoqoftë, mësimi për të drejtat e njeriut nuk ka qenë i përfshirë.

Në përpjekje për t'i përfshirë të drejtat e njeriut si lëndë në shkollat fillore, në vitin 2001

misioni i OSBE-së së bashku me Këshillin e Evropës, ka organizuar fushatën 'Kalendari i të Drejtave të Njeriut'. Zyrtarët e OSBE-së kanë shkuar nëpër shkolla në mbarë Kosovën duke shpjeguar dhe udhëhequr ushtrime dhe diskutime për të drejtat e njeriut dhe i'u kanë ndihmuar fëmijëve të shprehin me fjalë të tyre se çfarë domethënie kanë këto të drejta për ta. Ata që kanë qenë më kreativ janë përfshirë në faqet e kalendarit, të cilat



**Sven Lindholm**  
zëdhënës i misionit të OSBE-së në Kosovë

Të nderuar lexues,

Ky numër i Detajeve i dedikohet gati në tërësi të rinjëve, dhe adreson një numër të iniciativave dhe aktiviteteve edukative të cilat kanë për qëllim të përfshijnë një ndër burimet më të mëdha të Kosovës dhe t'i nxis ata të angazhohen në shkollat e tyre dhe në shoqëri. Parase gjithashtu kur kjo pjesë e madhe e popullatës janë e ardhmja e këtij vendi.

Pse është OSBE-ja e përfshirë në tërë këto? Si ta shpjegojmë mandatin tonë në lidhje me aktivitetet që kanë të bëjnë me rininë?

Më lejoni të fillojë me aktivitetet tona edukative, të cilat ndihmojnë ata që mund të ndihen të lënë anash dhe ata të cilët plotësojnë shkollimin që kanë marrë më parë. Së

pari, një kulturë e respektimit të të drejtave të njeriut po fillon të zhvillohet. Nuk është me rëndësi që ato të promovohet vetëm nga politikanët, policia dhe shoqëria civile, por edhe të mësohet për to në shkollat. OSBE-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ofron fëmijëve mësim për të drejtat e njeriut dhe i'u ndihmon atyre të kuptojnë rëndësinë e tyre. Shpresojmë se duke mbajtur këso lloj kurseesh në shkollat fillore, të rinjtë do t'i mësojnë dhe kuptojnë të drejtat e njeriut dhe do t'i promovojnë ato gjatë jetës së tyre.

Përveq mësimin për të drejtat e njeriut, OSBE-ja gjithashtu siguron të drejtën për arsimim për disa komunitete të cilat kanë mbetur të papërfshira. Fëmijët rom, ashkali dhe egjiptas nuk kanë ndjekur mësimin themelor. Edhe ata janë pjesë e shoqërisë, dhe me orët plotësuese të përkrahura nga MASHT-i, ata mund të bëhen si nxënësit e tjerë. Jo vetëm këto komunitete përfitojnë nga kjo, por edhe shoqëria si tërësi.

Dhe pastaj vjen ajo që njihet nga të gjithë, por që nuk kuptohet tërësisht, ngritja e kuadrove. Jashtë shkollës, të rinjtë i kontribuojnë shoqërisë edhe në mënyra tjera. Rrjeti i të Rinjëve në rajonin e Pejës ka fletushkën e vet, përmes së cilës të rinjtë i'u bëjnë me dije autoriteteve komunale brengat e tyre. Degët rinore të partive politike dhe organizata tjera

rinore në Kaçanik kanë ndjekur trajnime të organizuara nga OSBE-ja për lobim dhe avokim.

OSBE-ja gjithashtu punon për t'i njoftuar të rinjtë me proceset demokratike, dhe të angazhohet në institucione demokratike. Misioni i OSBE-së ka ndihmuar në themelimin e Kuvendeve Rinore në 10 komuna të Kosovës. Të rinjtë nga moshë 16 deri në 18 vjeçare imitojnë punën e kuvendeve komunale dhe mësojnë si të bashkëpunojnë, si t'i prezentojnë problemet e tyre në mënyrë efektive dhe si t'i zgjidhin ato për t'i arritur qëllimet e parashtruara. Secili grup, ngase vijnë nga komuna të ndryshme, kanë edhe brenga të ndryshme, por shumica duket se janë të drejtuar kah ambienti. OSBE-ja do të vazhdojë t'u ndihmojë Kuvendeve Rinore derisa ata bëjnë hapin tjetër drejt përfshirjes më të madhe në komunitetet e tyre.

Me sa duket njëri ndër aspektet kryesor të kësaj është se të rinjtë dëshirojnë ta fuqizojnë vetëveten. Ata po tregojnë se mund të bëhen faktorë të ndryshimeve.

Me tërë këto aktivitete, OSBE-ja po ndihmon në zhvillimin e një shkallë të re të inteligjencës në Kosovë, e cila do të kuptojnë më mirë domethënien e të drejtave të njeriut, do t'i promovoj ato, dhe do të bëhen kontribuese dhe pjesëmarrëse e dobishme në shoqëri. E ardhmja është tani.

### vijon nga fq. 1

janë ekspozuar në shkollat dhe qendra kulturore dhe të komuniteteve nëpër Kosovë.

Por, kjo përpjekje nuk ka qenë e vetqëndrueshme. Mësimi i të drejtave të njeriut nuk ka mund t'i lihet zyrtarëve të OSBE-së.

Në vitin shkollor 2003/2004, një pilot projekt për mësimin e të drejtave të njeriut është organizuar në tërë territorin e Kosovës, duke sjellur libra pune për të drejtat e njeriut për nxënës dhe libra udhëzues dhe të metodologjisë së mësimdhënies për arsimtarë në 70 shkollat. Të gjitha këto materiale janë hartuar nga ekspertët e OSBE-së në bashkëpunim dhe me miratimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

"Një vit i mësimin është treguar të jetë efektive. Vlerësimi i pilot projekteve ka qenë pozitiv dhe me përmirësime të vogla të materialeve MASHT-i ka vendosur ta inkorporojë mësimin për të drejtat e njeriut në planprogramin e edukimit qytetar për klasat e gjashta," thotë Ronald Hugiemstra, shef i seksionit për ngritjen e kuadrove në departamentin për të drejtat e njeriut në OSBE.

Viti shkollor 2004/2005 është përdorur për të rishikuar përmbajtjen dhe hartimin dhe shtypjen e materialeve mësimore që do të jenë të mjaftueshme për dy vitet shkollore në vijim (rreth 90,000 libra për nxënës, 2,000 udhëzues për arsimtarë dhe libra të metodologjisë).

Që nga shtatori i vitit 2005, të gjithë nxënësit e klasëve të gjashta në Kosovë do të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe domethënien e

tyre për jetën dhe familjet e tyre. Për të siguruar kualitet të mësimdhënies, MASHT-i dhe OSBE-ja do të trajnojnë afër 2,000 arsimtarë të edukatës qytetare mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe substancës së planprogramit të të drejtave të njeriut duke përdorur për trajnime në shtatë qendrat rajonale të MASHT-it.

Megjithatë, akoma ka probleme në këtë fushë. Ato burojnë nga situata e ndërlikuar politike dhe ekzistenca e strukturave paralele. Shkollat në gjuhën serbe nuk bashkëpunojnë me MASHT-in dhe nuk punojnë sipas planprogramit të saj (ato punojnë sipas planprogramit që aplikohet në Serbi).

Edhe pse ekziston një draft përkthim i këtyre materialeve për të drejtat e njeriut në gjuhën serbe, OSBE-ja akoma nuk është në gjendje të arrijë një marrëveshje për miratim dhe finalizim të tyre në mënyrë që të përdoren në shkollat në gjuhën serbe. Për këtë arsye, fëmijëve që i ndjekin këto shkollat i'u është mohuar qasja në orët e të drejtave të njeriut.

Për më tepër, shkollat në gjuhën boshnjake mund të kenë vonesa në mësimin e të drejtave të njeriut derisa t'u ofron librat e përkthyer.

Një pyetje tjetër është çka do të ndodh me mësimin e të drejtave të njeriut kur librat e siguruar nga OSBE-ja për dy vite shkollore do të harxhohen.

Këto pyetje janë çështje për të cilat duhet të përkujdesen politika dhe politikanët kur e diskutojnë dhe aprovojnë buxhetin e ardhshëm për edukimin e rinisë së Kosovës.

## DETAJE

Gazetë e publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

OSCE HQ, Prishtinë / Pristina, Kosovo  
Tel: +381 38 500 162, Fax: +381 38 500 188  
E-mail: [press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)  
Web site: [www.osce.org/kosovo](http://www.osce.org/kosovo)

Botuesi:  
Sven Lindholm

Kryeredaktor:  
Nikola Gaon

Redaktorë:  
Hasan Sopa, Armend Tahirsylaj (Detaje)  
Vasilija Stanić (Detalji)

Faqesja:  
Shpend Kada

Bashkëpunorët:  
Adelina Sokoli, Ardiana Sejdiu, Alan Skurbaty,  
Chris Cycmanick, Fatime Lepaja, Halide Sadiku,  
Mustafa Skenederi, Mevlode Salihu, Radka Betcheva,  
Rexhep Krasniqi, Joseph Flood, Silvia Eckert, Jade  
Duchesneau-Bernier, Ljubiša Simić, Shpetim Mustafa,  
Vasilija Stanić, William Henley

**osce**  
Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.



# Qendra Juridike e Kosovës arsimon rininë

Qendra Juridike e Kosovës (QJK), e financuar nga OSBE-ja, përfaqëson një institucion që punon në kultivimin e aftësive profesionale ligjore dhe në avancimin e kulturës për respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit në tërë shoqërinë.

**Adelina Sokoli, KLC and Nikola Gaon, OSBE**

Të rinjtë janë një prej caqeve kryesore të kësaj qendre dhe arsimimi i tyre është primar në agjendën e tyre. Duke ditur se arsimimi për qeverisje dhe legjislacion duhet t'i përshtaten të rinjve të moshave të ndryshme, QJK-ja ka përpiluar programe që u përshtaten secilit prej tri grupeve kryesore: nxënësve të shkollës fillore, të mesme dhe studentëve.

Krahas sigurimit të arsimimit, QJK-ja gjithashtu orvatet t'i motivojë të rinjtë të mendojnë në mënyrë kritike dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në shoqërinë demokratike. "Ne duam t'i bëjmë ata të vetëdijshëm për 'rregullat e lojës' kur bashkëveprojnë me administratën publike në përpjekje të përkrahjes për ndryshime," thotë Adelina Sokoli, menaxhere në QJK.

Për më tepër, në QJK besojnë se është e rëndësishme rrënjosja e ndjenjës së rëndësisë së sundimit të ligjit tek të rinjtë. "Vetëm nëse të rinjtë i dijnë dhe i kuptojnë të drejtat themelore të tyre, strukturat e sistemit ligjor dhe rregullat themelore të ligjit të Kosovës, ata do të jenë në gjendje të çmojnë, respektojnë dhe përkrahin sistemin politik të Kosovës të bazuar në sundimin e ligjit", shton z. Sokoli.

Duke bërë vetëdijësim të rinjve për 'rregullat e lojës' në sistemin demokratik, të kombinuara me njohjen e të drejtave ligjore dhe rolin e qytetarit si bashkëpjesëmarrës e jo si shikues në demokraci, do t'i inkurajojë atë të bëhen anëtarë aktivë të shoqërisë Kosovare.

Programi aftësues i fakultetit të drejtësisë së QJK-së përfshin klinikat e praktikës ligjore që u ofrojnë studentëve mundësi t'i ngrisin aftësitë e tyre praktike ligjore, përmes përpilimit të memorandumeve, siç janë, paditë, vendimet dhe ankesat dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në gjykime të imituara. Së fundi, QJK-ja organizoi një udhëtim studiues në

Francë, ku u dha mundësinë 11 studentëve t'i zgjerojnë njohuritë mbi ligjin ndërkombëtar dhe zbatimin e tij, dhe për ta kuptuar më mirë rolin e organizatave ndërkombëtare në shoqërinë evropiane duke i përgatitur ata për marrëdhëniet e ardhshme me homologët ndërkombëtarë.

Për t'i pëmirësuar kushtet në të cilat studentët punojnë, QJK-ja është duke ndihmuar në zhvillimin e bibliotekës së fakultetit të drejtësisë dhe në botimin e publikimeve për ligjin e zbatueshëm si dhe në botimin e doracakëve të shumë akteve ligjore dhe si të bëhen kërkime dhe të përpilohen dokumentet kërkimore.

Duke punuar me nxënësit e shkollave të mesme në kuadër të programit ligjor për arsimim të rinisë për ligjin, QJK-ja ka organizuar një numër të sesionve trajnuese në lidhje me ligjin për të drejta të njeriut dhe praktikën demokratike. Duke i adresuar temat bashkëkohore, në bashkëpunim me OJQ-të vendore, QJK-ja përpiloi doracakun për të drejta të njeriut, ligjin dhe demokracinë, i cili

u dedikohet të rinjve dhe është përdorur në këto trajnime.

Duke mos i harruar më të rinjtë, QJK-ja ka udhëhequr edhe projektin 'Arsimimi për Komunikacion' për fëmijë deri në moshën 14 vjeçare. Projekti u ofroi atyre një qasje në njohjen e rregullave të komunikacionit, por, çka është më me rëndësi, projekti u mundëson atyre një vështrim në të drejtat themelore të fëmijëve. Qëllimi i projektit ishte t'i mësojë fëmijët ta respektojnë ligjin dhe t'i kuptojnë përfitimet nga kjo sjellje. Partner në këtë projekt ishte Shërbimi Policor i Kosovës.

Në përpjekje për t'i filluar disa tema të nxehta në Kosovë, QJK-ja e bëri një kërkim mbi dukurinë e vrasjes në Kosovën e pas konfliktit. Objektivi i projektit ishte që t'u ofronte institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe opinionit vendor, informatat të cilat do t'u ndihmonin atyre për ta luftuar më mirë këtë lloj krimi.

Elementi arsimor nuk mungoi as këtu. Studentët e fakultetit të drejtësisë patën rolin e kërkuesve të ri.



Qendra Juridike e Kosovës ofron edukim për të drejtat e njeriut për fëmijë dhe të rinjtë të grupmoshave të ndryshme. Mbase në qendër të vëmendjes së tyre janë studentët e univerzitetit.

# Ndërtimi i një platforme të përbashkët në Kosovë

## Takim pune i Kuvendeve Rinore në Zhabllak, Mali i Zi

“Ky është vetëm fillimi. Të tjerë janë duke ardhur pas nesh. Ata mund të ndërtojnë mbi bazën që e kemi filluar këtu”.

**Mustafa Skenderi, OSBE**

Këto ishin fjalët e Lindita Agushit (18 vjeçare) dhe Ivana Radosavljeviqit (17 vjeçare) të cilat morën pjesë në seminarin e organizuar për anëtarët e dhjetë Kuvendeve Rinore nga e tërë Kosova në gusht të këtij viti në Zhabllak të Malit të Zi. Qëllimi i seminarit ishte që të krijohet një platformë e përbashkët për angazhimet shoqërore të të rinjëve. Numri i pjesëmarrësve në këtë seminar ishte mbi 270. Ata ishin të ndarë në dy grupe dhe secili grup punoi nga tri ditë, i pari prej 19 deri më 22 gusht dhe i dyti prej 23 deri 26 gusht.

### Përvojat nga bota

Bazuar në përvojën dhe iniciativat e të rinjëve nga e tërë bota, misioni i OSBE-së në Kosovë filloi implementimin e projektit për Kuvendet Rinore në nivel komunal në vitin 2003. Qëllimi ishte që proceset demokratike t'u prezantohen të rinjëve dhe adoloshentëve të moshës 16-18 vjeçare, të cilët po i ofrohen moshës për marrjen e drejtave të plota civile. Aty, ata mësuuan edhe se si të kyqen në punën e institucioneve qeveritare dhe OJQ-ve të niveleve komunale dhe qendrore, si t'i paraqesin problemet e tyre në një mënyrë më të efektshme dhe si të punojnë që t'i zgjedhin ato.

Anëtarët e parë të kuvendeve janë zgjedhur dy vite më parë me ndihmën e drejtorëve të shkollave të mesme. Pjesëmarrësit e parë pastaj kanë rekomanduar anëtarët e ri të jen pasardhës të tyre.

Kuvendet Rinore imitojnë plotësisht punën e Kuvendeve Komunale. Anëtarët e asambleve rinore votojnë për të zgjedhur kryetarin, shefin e ekzekutivit dhe nënkryetarin. Statuti i tyre është i njëjtë me atë të kuvendeve komunale. Dallimi i vetëm është se këta anëtarë janë nxënës të shkollave të mesme të cilët nuk janë më të vjetër se 18 vjeçar. Përmes simulimit të punës së kuvendit, ata mësojnë se si të bashkëpunojnë me organet komunale dhe si t'i arrijnë qëllimet e tyre.

Për shembull, në Dragash, qëllimi ishte që të mbështetet zhvillimi i turizmit në Gorë. Me ndihmën financiare të komunës, Kuvendi Rinor shënoi të gjitha pikat e rëndësishme dhe vuri shenja për të drejtuar vizitorët.

### Në Zhabllak

Para restorantit “Javorovaca” në Zhabllak ishte ngritur një tendë e madhe. Megjithatë, tenda ishte e vogël për të gjithë pjesëmarrësit

e grupit të dytë të seminarit. Ata ishin më shumë se 140. Disa grupe të rinjsh ishin ulur në lëndina dhe e tregonin prezencën e tyre duke pëshpëritur, përmes zhurmës si dhe ndonjëherë duke bërtitur dhe e tëra me ndjenjën e diskutimit me dëshirë që zëri i tyre të dëgjohet më shumë se ai i të tjerëve si dhe të shprehin njohuritë e tyre. Dikush duke shikuar anash do të thoshtë “të rriturit ende luajn si fëmijët, shumë joserioze. Ndoshta edhe duket ashtu, por Biserka Jovanoviç, kordinatore e projektit pranë OSBE-së thotë, “Në fakt, këto lojra kanë një qëllim. Ato relaksojnë fëmijët që të tejkalojnë pengesat që ekzistojnë në fillim”.

Ishte hera e parë në këtë gusht që anëtarët e dhjetë Kuvendeve Rinore nga dhjetë qytete të Kosovës: Prizreni, Dragashi, Suhareka, Rahoveci, Lipjani, Gjilani, Kamenica, Vushtrria, Leposaviqi dhe Podujeva u takuan së bashku. Përmes këtyre lojrave interaktive, ata u njoftuan me njëri tjetrin, u bënë shokë dhe filluan të flasin haptazi rreth problemeve të tyre.

“Në fakt, ky është një rast që anëtarët e të gjitha Kuvendeve Rinore të takohen me njëri tjetrin, të shkëmbejnë ide, krijojnë kontakte, ndejnë shpirtin e punës ekipore të kuvendeve rinore”, thotë Methju Mins, menaxher i projektit të Kuvendeve Rinore pranë OSBE-së.

Një grup trajnuesish, anëtarë të OJQ-ve nga Gjilani dhe Rahoveci, ishin të angazhuar që të punojnë me të rinjtë të Zhabllakut pasi që ata kanë një përvojë të pasur me këtë lloj seminaresh.

Nexhat Ismaili, njëri nga udhëheqësit e seminarit nga OJQ “Aksioni për paqe kundër dhunës” nga Gjilani thotë se puna me të rinjtë është një kënaqësi e jashtëzakonshme për të. “Qëllimi është që këto grupe të komunikojnë përmes diskutimeve joformale, por gjithashtu edhe të ruajnë energjinë për pjesën e dytë të seminarit, kur ata do të duhet të diskutojnë, marrin iniciativa dhe mundohen që të zgjedhin problemet që i kanë identifikuar gjatë pjesës së parë të seminarit duke zhvilluar të ashtuquajturat “lojra”.

Edhe pse ky është seminari i pestë në të cilin ajo merr pjesë, Lindita thotë se kjo ishte hera e parë që ajo kishte takuar anëtarë të Kuvendeve të tjera. Duke krahasuar seminarin e Zhabllakut me ata të mëparshmit,



Kuvendet komunale të të rinjëve nga gjithë Kosova, në gusht të këtij viti u takuan me qëllim të ndërtimit të një platforme të përbashkët lidhje me veprimet e tyre në të ardhmen në nivel qendror.



ajo thotë se karakteri i këtij u jep mundësi atyre që të kënaqen më shumë dhe është më i përshtatshëm. "Loja nuk është vetëm lojë, këtë e kam kuptuar këtu. Duhet të nxirren mësim nga loja e sotshme dhe qëllimi është realizuar. Ajo na udhëhoqi deri në vazhdimin e sesionit të sotshëm kur ne filluam të flasim për problemet të cilat na brengosin ne dhe të hulumtojmë mënyrat për zgjedhje të mundshme dhe të kërkojmë personat të cilëve duhet t'iu drejtohem".

Kryetari i Kuvendit Rinor të Leposaviqit, Branislav Neshoviq, 19 vjeçar, i cili ka dhënë dorëheqje, thotë se ky ishte një rast për të personalisht që të takojë anëtarët e Kuvendeve Rinore të vendeve tjera nga Kosova. "Anëtarët e Kuvendit nga Leposaviqi nuk kanë pasur asnjëherë rastin që të takohen me anëtarët e Kuvendeve Rinore të komuniteteve tjera. Ne vetëm kemi dëgjuar për njëri tjetrin, por tani jemi këtu së bashku, mund të bisedojmë dhe të shkëmbejmë mendime pa paragjykim dhe pengesa".

Për këta të rinjë, të cilët në të ardhmen mund të bëhen politikanë, profesorë, apo anëtarë të OJQ-ve, pjesëmarrja në kuvende ua ka ndryshuar disi jetën e tyre.

"Ndihehem më i matur, të rriturit më dëgjojnë me vëmendje se çka kam për të thënë, dhe unë kam fituar vetëbesim", thotë Vlora Cakolli, 18 vjeçare. Kur Vlora ishte 16 vjeçare, ajo u bë kryetare e Kuvendit Rinor në Kamenicë. Duke marrë pjesë në seminare të ndryshme të organizuar nga OSBE-ja, ajo mësoi se si t'i udhëheqë njerzit e ndryshëm, si t'i bashkojë ata rreth një ideje, si t'i organizojë ata si dhe si të jet gjithmonë e përgjegjshme dhe e sinqertë. "Kjo është një përvojë e madhe për mua. Pa marr parasysh se çfarë profesioni do të zgjedhë në të ardhmen, kjo përvojë gjithmonë do të më shërbejë".

## Vazhdimi i Punës

Gjatë dy viteve të kaluara, strukturat komunale e kanë marrë punën e Kuvendeve Rinore shumë seriozisht. Për shembull, Kuvendi Rinor në Podujevë organizoi një debat të hapur për implementimin e standardeve në komunën e tyre. Pas këtij debati, të rinjtë e Podujevës dhanë idenë për bërjen e një filmi dokumentar se çka është duke bërë qeveria komunale për implementimin e standardeve.

Pas këtij seminari, Kuvendet Rinore do të shkojnë një hap më tutje. Parashihet që përfaqësuesit e të gjitha Kuvendeve Rinore do të formojnë një kuvend qendror sipas modelit të Kuvendit të Kosovës. Të rinjtë do të mundohet që t'ua tërheqin vëmendjen institucioneve qendrore për problemet e tyre. Në të njëjtën kohë, ky do të jet edhe një rast për ta që të mësojnë se si punon Kuvendi i Kosovës si dhe si funksionojnë Ministrinë.

# Kasneci

Zyra e OSBE-së në Pejë ka filluar publikimin e gazetës Kasneci në gusht të vitit 2001. Katër vite më vonë, gazeta arrin në duart e lexuesve rregullisht, tani me përmbajtje dhe formë të përparuar.

## Mevlyde Salihu, OSBE

Gazeta Kasneci është një urë në mes të institucioneve vendore dhe qytetarëve në rajonin e Pejës. Të rinjtë që jetojnë në këtë rajon i shprehin brengat dhe prioritetet e tyre në gazetën Kasneci, kurse autoritetet vendore kuptojnë çështjet që banorët mendojnë se duhet të zgjidhen urgjentisht.

Kasneci është projekti i parë shumetnik në këtë rajon, dhe një ndër publikimet e para në Kosovë në gjuhën shqipe dhe boshnjake/serbe. Gazeta mbulon komunën e Pejës, Deçanit, Istogut, Gjakovës dhe Klinës dhe del një herë në tri javë.

Çështjet kryesore në gazetë i adresojnë brengat e qytetarëve të këtyre komunave, me qëllimin parësor të informojë institucionet dhe zyrtarët e qeverisë lokale për problemet e tyre.

Projekti është inicuar nga zyra e OSBE-së në Pejë, por organizata joqeveritare vendore Syri i Vizionit ka qenë partner implementues që nga fillimi. "Pesë numrat e fundit janë përgaditur plotësisht nga Syri i Vizionit, përderisa OSBE-ja vazhdon ta përkrah projektin financiarisht," thotë Albert Prenkaj, zyrtar për demokratizim pranë zyrës së OSBE-së në Pejë.

Çështjet që adresohen në gazetë kanë të bëjnë me jetën e përditshme të qytetarëve. "Gazetarët, shqiptarë, boshnjakë dhe serbë të Kosovës, i marrin idetë duke folur me qytetarët për çështjet që ata mendojnë se janë prioritet, dhe pastaj shkruajnë për ato çështje," tha Veton Mujaj, drejtor ekzekutiv i OJQ-së Syri i Vizionit.

"Ne gjithmonë sigurohemi që secili numër i Kasnecit të është në duart të zyrtarëve të qeverisë lokale, në mënyrë që ata të kuptojnë se cilat janë çështjet që qytetarët i shohin si prioritet dhe t'i zgjidhin ato," thotë Mujaj.

Gazeta ndan hapësirë për secilën komunë që e mbulon, por ka edhe një faqe për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet etnike. Përveq kësaj, gazeta ka ndarë një faqe ku publikohen opinionet e qytetarëve të thjeshtë.

"Kemi një faqe të posaçme ku i botojmë opinionet e qytetarëve," tha Mujaj. "Kjo është në të njëjtën kohë edhe mënyrë e mirë që të kuptojmë se sa lexohet Kasneci. Nëse vazhdimisht marrim artikuj nga qytetarët, kjo tregon se ata e lexojnë Kasnecin."

Kasneci shpërndahet falas. Gazeta shpërndahet në të gjitha institucionet e të pesë komunave, si dhe nëpër kiosqe, ku gjinden edhe gazetat dhe revistat tjera ditore. Kasneci poashtu shpërndahet nëpër kafteri për të arritur deri tek të rinjtë.

Artikujt e publikuar në Kasnec shpesh kanë përshpejtuar zgjidhjen e shumë çështjeve. Mujaj thotë se si rezultat i artikujve të publikuar në gazetë, disa shenja në rrugë janë ndryshuar, ose janë vendosur të reja.

"Ka pasur raste kur shenjat në rrugë kanë qenë të vendosura gabimisht dhe i kanë hutuar qytetarët. Ata janë ankuar, ne kemi botuar artikuj në gazetë, dhe autoritetet lokale kanë bërë atë që është pritur prej tyre, i kanë ndryshuar shenjat, ose i kanë vendosur aty ku ka qenë e domosdoshme," thotë Mujaj.

"Banorët e një lagjeje në Pejë kanë pasur problem me një kanal që ka kaluar nëpër rrugën e tyre. Pas shumë artikujve të botuar në Kasnec, komuna ka vendosur të ndërmarr diçka," Muja përmend një shembull tjetër të ndikimit të Kasnecit në autoritetet lokale.

Gazeta ka pësuar ndryshime që nga koha kur ka filluar të publikohet. Ka ndryshuar në formë dhe përmbajtje, duke u përmirësuar kështu dhe duke u bërë më profesionale. Tani, gazetarë profesionistë shkruajnë për të, dhe ka korrespondentë në Klinë, Gjakovë, Istog dhe Deçan, të cilët mbulojnë komunat e tyre.

Edhe pse organet komunale kanë mendim kritik për Kasnecin, pasi që gazeta shpesh e kritikon punën e tyre, punëtorët e Syrit të Vizionit shpresojnë se ata së shpejti do të kuptojnë që Kasneci mundohet t'i ofrojë qytetarët dhe autoritetet dhe qëllimi i vetëm i tij është ta bëjë jetën më të mirë për të gjithë.

Si një mënyrë për ta bërë gazetën të vetqëndrueshme, Syri i Vizionit kohëve të fundit ka filluar të publikojë reklama në gazetë. "Marketingut i'a kemi dedikuar një hapësirë të vogël," thotë Mujaj, pasi që dëshirojmë të sigurojmë mënyra që të bëhemi të vetqëndrueshëm." Deri atëherë, Kasneci do të vazhdon të ekzistojë falë përkrahjes financiare të OSBE-së.



Gazetarët e gazetës Kasneci shkruajnë për problemet dhe zhvillimet në komunitetin e tyre. Ata ndihmojnë në ofrimin e popullatës me zyrtarët lokal.

# Arsimim për të gjithë: Riintegrimi i minoriteteve në sistemin shkollor

Çdo prind është i vetëdijshëm se cilësia e shkollimit të fëmijës ndikon shumë në perspektivën për punësim dhe jetë të lumtur për një të rritur. Arsimi gjithashtu luan një rol vendimtar në avancimin e integritit brenda komuniteteve, ndërtimi i një baze solide të shoqërisë në të cilën mund të ndërtohet një ekonomi dinamike dhe e suksesshme. Prandaj, përforsimi dhe gjithëpërfshirja e sistemit shkollor është një indikator i rëndësishëm për shëndetin dhe stabilitetin e të ardhmes së shoqërisë.

William Henley, OSBE



Fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas shpesh u mungon qasja në arsimim fillor. Orët plotësuese u ndihmojnë atyre që t'i kompenzojnë orët e humbura.

Shumë shpeshë fëmijët nga minoritetet nuk ndjekin shkollimin në Kosovë. Kjo veçanërisht ndodhë me komunitetin rom, ashkalinj dhe egjiptas. Dhe kjo ndikon negativisht në shoqëri si tërësi duke penguar aftësitë e gjeneratave me individ të talentuar që pozitivisht të kontribuojnë për jetën këtu.

Ekzistojnë një numër arsyes për ndjekje të dobët të shkollimit, përfshirë këtu punësim të hershëm, izolim, sigurim të dobët, paragjykim dhe mungesë të vetëdijësisimit në mes të qeverisë dhe pushtetit lokal. Madje edhe pse fëmijët janë të gatshëm dhe të aftë për të ndjekur shkollimin, qasja shpeshë është e vështirë sepse ata kanë pasur ose nuk kanë pasur as shkollim fillor. Shumë nga ata nuk dijnë as shkrim dhe lexim.

## Plotësimi i kohës së humbur

Duke marrë parasysh këtë, misioni i OSBE-së ka ofruar këshilla, mbështetje logjistike dhe financiare gjatë viteve të kaluara për projektin 'mësimet plotësuese. Qëllimi ishte përmirësimi i qasjes në rrjedhat kryesore të arsimit për nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve. Mësimet filluan në shtator 2004 dhe zgjatën për nëntë muaj, duke përfshirë planprogramin të cilin e nxjerrë qeveria, me mësim nga matematika, shkenca, gjeografia, letërsia dhe gjuhët.

Koordinatorët e projektit janë përballur me sfida të pakëndshme gjatë vitit pasi që në shumë paralele fëmijët i kishin humbur deri në shtatë vite shkollim. Përkundër kësaj, entuziazmi nuk ishte zbehur fare.

Një nga koordinorët lokal të përkushtuar është Indira Elshani, përgjegjëse për orgnazimin e mësimëve plotësuese në Prizren. "Ne kemi nevojë për eliminimin e analfabetizimit dhe t'u japim këtyre fëmijëve mundësi për një të ardhme më të mirë", thotë ajo.

Mbështetja e OSBE-së për këtë projekt, i cili ishte inicuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka përfshirë edhe shpenzimet e koordinorëve vendor dhe materialin mësimor në tetë komuna: Lipjan, Pejë, Prizren, Suharekë, Istog, Shtime, Gjakovë dhe Prishtinë.

Gjithësej, afër 500 fëmijë romë, ashkalinjë dhe egjiptas në mes të moshës gjashtë dhe pesëmbëdhjetë vjeçare kanë përfutuar gjatë viteve të kaluara akademike.

## Kurse për rrobaqepësi

Mësimdhënësit përpiqen që të krijojnë ngritje akademike të nxënësve deri në nivelin e kërkuar për mundësi inkuadrimi në shkollim të rregullt. Për shumë nxënës, kjo ishte përvoja e tyre e parë, ndërsa të tjerët kanë humbur aq shumë mësim sa që duhet të përsërisin të gjitha mësimet shkollore.

Sipas Xhevat Nezirajt, koordinor vendor për Pejë, ky lloj mësimi u ka dhënë mundësinë e integritit të nxënësve madje edhe pse kanë qenë jashtë sistemit të shkollimit normal për një kohë të gjatë. Ai ka organizuar mësimin plotësues në shkollën fillore Vaso Pashë Shkodrani.

Zyra është nxënëse e klasës së gjashtë. "Orën e fundit kemi mësuar për biologjinë dhe qelizat", tha ajo. "Mua me të vërtetë më pëlqen

kjo mënyrë e të mësuarit. Kjo do të thotë ne do të jemi në gjendje të shpejtojmë me klasët të cilat nuk kemi arritur t'i përfundojmë më heret".

## Mundësi më të mëdha

Sipas Saskia Marsh, zyrtare e OSBE-së dhe person përgjegjës për këtë projekt, mësimet kishin bërë vërtet ndikim pozitiv, megjithëse ajo pranoi se ende mund të bëhet përparimi i mëtej. Me arsimim, komuniteti rom, ashkalinj, dhe egjiptas janë në pozitë më të mirë për t'i plotësuar nevojat e veta, tha ajo.

"Fëmijët afrohen me moshatarë të etnive tjera më lehtë përmes bashkëpunimit. Filimisht kjo ndodhë përmes aktiviteteve nga planprogramet e veçanta, që organizohen si pjesë e mësimëve të përsheptuara, dhe eventualisht përmes inkuadrimin në shkollim të rregullt".

Përveç mundësisë për integritin, shpresa afatgjate është se me krijimin e mundësisë për punësim individual, me anë të mësimin themelor në shkollë, mësimet e bazuara në ekonomi vendore mund të zgjerohen. Levërditë janë për të gjitha komunitetet, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

Megjithatë koordinorja e planprogramit pranon se projekti nëntë mujor i mësimëve plotësuese nuk mjafton për të plotësuar nevojat e shkollimit për të gjithë fëmijët. "Për të plotësuar qëllimet e veta, është e qartë se nxënësit kanë nevojë edhe për dy deri tri vite për të kryer shkollimin e tyre fillor", thotë Marsh.

Janë edhe disa fusha tjera që kërkojnë vëmendje, siç është përmirësimi i pjesëmarrjes së barabartë të të dy gjinive dhe ofrimi i mësimëve plotësuese për fëmijët jo shqiptar.

## "Ne dëshirojmë të jemi si të gjithë fëmijët tjerë".

Megjithatë, me mësimdhënësit, nxënësit, dhe prindërit, të gjithë entuziast për këtë projekt, shpresohet se stimulimi dhe mbështetja e ofruar nga OSBE-ja në vitin fillestar do të jetë e mjaftueshme të arsyetojë vazhdimin dhe zgjerimin e ardhshëm aq gjatë sa përkushtimi i partnerëve vendor dhe veçanërisht Ministrisë, mund të jetë e pandërprerë.

"Unë dua t'i ndjek mësimet vitin e ardhshëm", tha Zyra. "Jo vetëm unë, por të gjithë, ne nuk dëshirojmë të mbesim mbrapa. Ne dëshirojmë të jemi si të gjithë fëmijët tjerë".



# Vetëdijësimi politik i rinisë në Kaçanik

Pas dy muajsh trajnime për vetëdijësim politik, të organizuar nga zyra e OSBE-së në Shtërpçë, ceremonia e diplomimit të më tepër se 30-të të rinjve nga Kaçaniku, u organizuar në Hotel Evropa në Kaçanik. Trajnimet përfshinin temat siç janë përfshirja e rinisë në institucione demokratike, avokimi, të drejtat e të rinjve, lobimi, etj.

**Mustafa Skenderi, OSBE**

Gjashtë vite pas përfundimit të konfliktit në Kosovë ende nuk ka asnjë OJQ të rinjve, krahe rinorë të partive politike apo ndonjë organizatë tjetër joformale nga Kaçaniku, që ka arritur të afirmojë vetëveten dhe të përfshihet në jetën publike ose politike të komunës. Nga kjo del se askush nuk i ka adresuar çështjet të cilat janë brengosëse për rininë apo qytetarët tjerë të komunës. Lobimi është ende një koncept shumë i largët.

Projekti “Vetëdijësimi Politik i Rinisë në Kaçanik”, i implementuar nga zyra e OSBE-së në Shtërpçë, aktualisht ka për qëllim përmirësimin e komunikimit në mes shoqërisë civile, në këtë rast rinisë, dhe organeve komunale, si dhe ngritjen e nivelit të njohurive të të rinjve lidhur me përfshirjen e tyre aktive në jetën publike dhe proceset demokratike në komunë.

OJQ-ja e posaformuar ‘Iniciativa Rinore’ nga Kaçaniku, organizatë partnere në këtë projekt, ka implementuar me sukses pjesën e vet të punës të parashikuar nga draftprojekti, thotë Muhamed Sagdati, koordinatori i projektit nga zyra e OSBE-së në Shtërpçë. Ata identifikuan dhe angazhuan anëtarë potencial, përfaqësues të rinj të partive politike,

studentë dhe nxënës që veç kishin qenë të organizuar në shkollat dhe fakultetet e tyre, apo ishin vetëm një dekor i partive të tyre politike.

“Kur ne filluam kishim probleme, por me këto gjëra ballafaqohemi edhe gjatë implementimit të projekteve tjera. Në fillim njerëzit nuk besojnë në aktivitete të projekteve të ndryshme. Por pastaj, gjatë sesionit të dytë apo të tretë dhe pas fushatës promovuese me anë të mediave dhe pllakatave të vendosur nëpër qytet, u rrit interesimi dhe ne hasëm në problemin e gjetjes së një vendi të përshtatshëm për të punuar normalisht”.

Projekti përfshiu trajnuesit vendor, profesorët dhe ekspertët për shoqëri civile, si dhe puntorë të organeve vendore. Kjo inicoi diskutime spontane në mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve. Janë mbajtur gjithsej pesë trajnime, ku të rinjve i u prezentua koncepti i shoqërisë civile, roli i rinisë në shoqërisë civile, avokimi për problemet dhe interesat e shoqërisë, roli e mediave, çështjet gjinore, etj.

Gjatë pranimit të diplomës, Armend Brruti, pjestarë i OJQ-së “Wake up” (Zgjohu) nga Kaçaniku, thotë se ai ka përfutuar shumë dhe

ishte i impresionuar nga trajnimet. “Unë përfitova shumë nga ky trajnim. Unë kam mësuar shumë gjëra të reja; si të lojtmë, si t’i përkrahim intereset tona, dhe si funksionojnë kuvendet komunale. Unë gjithashtu mësova edhe për të drejtat e të rinjve”.

Diturie Neziri ka mendim të ngjashëm, por ajo do të ishte më e knaqur sikur të shihnte një aplikim të suksesshëm të njohurive të fituara nga këto trajnime. “Ne dëshirojmë të jemi pjesëmarrës aktiv të shoqërisë civile. Trajnimi është forca jonë shtyrëse për t’u ngritur në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe politike të komunës sonë. Nëse ne ia dalim të implementojmë gjysmën e asaj që kemi mësuar në këto trajnim, unë do ta konsideroj këtë si sukses të madh”.

Me qëllim të njohjes me punën e organeve komunale, rinia pati një mundësi për të parë se si funksionojnë gjërat në praktikë. Domethënë, delegacionet u formuan dhe ishin prezente në seancat e Kuvendit Komunal, në sesionet e bordit qeverisës si dhe në komisione tjera. Duke folur për mënyrën se si do të reflektohen aktivitetet e rinisë në punën e komunës, Ibrush Vishi, drejtor i departamentit për sport dhe kulturë në Kaçanik, thotë: “Besoj dhe jam i sigurt se kjo do të ketë një efekt pozitiv. Kjo do të provokojë dhe do të shtoj interesimin e të rinjve që të marrin pjesë në jetën publike dhe në punën e institucioneve publike. Në anën tjetër, deri sa ata zhvillojnë aftësitë e tyre, do të na vëzhgojnë dhe korrigjojnë neve, sepse është normale që ne bëjmë gabime në punë”.

Me qëllim që kjo iniciativë të mos përfundojë me finalizimin e trajnimeve, zyra e OSBE-së në Shtërpçë do të vazhdojë të përkrah punën e OJQ-ve rinore. Me iniciativën e zyrës së OSBE-së gjatë sesioneve të trajnimit u themelua një OJQ e quajtur ‘Forumi’. Pjestarët e kësaj OJQ-je, përfaqësues të të gjitha OJQ-ve dhe shoqatave rinore nga Kaçaniku, do të mundohen të unifikojnë dhe përgjithësojnë punën në platformën e përbashkët.

“Është vështirë të flitet për qëndrueshmëri, ngase ka një mungesë të fondeve në sektorin civil, donatorët nuk ishin prezent në Kaçanik, dhe disa do të duhet të shikojnë të ardhmen e tyre në sferën e regjionalizimit. Hapi i tyre në të ardhmën do duhej të ishte krijimi i kontakteve me OJQ-të regjionale. Në epokën e mjeteve të komunikimit masiv kjo nuk do të duhej të paraqiste problem”, përfundon Muhamed Sagdati.



Misioni i OSBE-së në Kosovë punon me të rinjtë në nivel qendror dhe lokal për vetëdijësimin e tyre në aspektin politik. Përfshirja e të rinjve në punën e institucioneve vendore dhe në proceset vendimarrëse është njëra ndër prioritetet e OSBE-së.

# Kampi veror: Liderët e ardhshëm 2005

“Si të rinjtë të Kosovës, ju duhet të bartni shpresat dhe dëshirat e të gjithë atyre që kanë vuajtur në të kaluarën. Në të vërtetë, ju mbani çelësin për të ardhmen e Kosovës. Me kohë, ju do të keni përgjegjësinë e udhëheqjes së Kosovës dhe formësimin e së ardhmes së saj,” tha Stiv Benet, drejtor i departamentit të OSCE për zhvillim dhe edukim të policisë gjatë hapjes së kampit rinor në shkollën policore në qershor të këtij viti.

**Hasan Sopa, OSBE**

Duke marrë parasysh faktin se të rinjtë në Kosovë përbëjnë një pjesë të madhe të popullatës – 60% e banorëve janë nën moshën 30 vjeçare – përpjekjet e OSBE-së për të arritur të rinjtë paraqet një rëndësi të madhe në punën e misionit. Kjo sfidë bëhet edhe më e madhe për faktin se këta të rinjtë janë ata që do ta ndërtojnë shoqërinë moderne të Kosovës.

Duke inkorporuar trajnimin dhe zhvillimin e policisë me aktivitetet për të rinjtë, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), e udhëhequr nga OSBE-ja, angazhohet në aktivitetet afatshkurtra dhe afatgjata për ngritjen e aftësive të policisë për t’iu përgjigjur çështjeve rinore dhe për të rrenjosur ndjenjën e përgjegjësisë dhe respektit për sundimin e ligjit tek të rinjtë.

Në vitin 2004, misioni i OSBE-së në bashkëpunim dhe me përkrahjen e departamentit të drejtësisë së SHBA-ve ka filluar organizimin e kampeve rinore në shkollën e SHPK-së. Vlerësimi pozitiv i dy kampeve të organizuara gjatë viteve të fundit ka çuar në organizimin e Kampit Rinor Liderët e Ardhshëm 2005. Këtë herë, organizimi i kampit ka përfshirë njësinë e SHPK-së për Policinë në Komunitet si dhe pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut. Karakteri i tij shumetnik është duke ndihmuar në përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike në mbarë Kosovën.

Kampet rinore, duke përfshirë edhe kampin e fundit të organizuar në fund të qershorit dhe fillim të korrikut, i’u ka mundësuar pjesëmarrësve të kenë ndikim të rëndësishëm në komunitetet e tyre. Ata përfituan njohuri edukative për përgjegjësitë civile, menaxhimin e konfliktit dhe zgjidhjet e problemeve në mënyrë paqësore të cilat i kanë aplikuar pasi janë kthyer në shtëpi.

Sipas Nerimane Gërgurit nga ekipi koordinues i kampit, kampi i fundit ka qenë më i madhi me gati 250 pjesëmarrës. Për dallim nga dy kampet tjera të cilat kanë zgjatur tri ditë, ky i fundit ka zgjatur 5 ditë, nga 29 qershori deri më 3 korrik. “Gjatë këtyre pesë ditëve, të rinjtë që kanë përfaqësuar komunitete të ndryshme kanë pasur mundësi të mësojnë së bashku, të ndajnë përvojat, vënë kontakte dhe të zhvillojnë kualitete dhe shkathtësi si liderët të ardhshëm, si dhe të krijojnë partneritet me policinë”, tha ajo.

Aktivitetet e kampit rinor janë organizuar në atë mënyrë që të ketë bashkëveprim në mes të pjesëmarrësve. “Ato janë të përpiluara për t’iu ofruar atyre mundësi për të zhvilluar shkathtësi udhëheqëse dhe përgjegjësi civile, duke kombinuar argëtimin dhe mësimin interaktiv”, tha Juliana Hertvek, koordinatore e kampit. “Për të përmendur vetëm disa nga pikat kryesore, ka pasur gara sportive, aktivitete sportive me karakter jogarues, një punëtori arti ku të rinjtë kanë krijuar një banderolë për të ardhmen e Kosovës si dhe shumë aktivitete tjera interaktive, të cilat kanë krijuar një ambient shumë miqësor”.

Ajo që është më me rëndësi, këto kampe vlerësohen lartë nga pjesëmarrësit e rinjtë. Sevgi Sunguri nga Gjimnazi Eqrem Çabej në Vushtri duket se është kënaqur gjatë gjithë kohës. “Me të vërtetë më ka pëlqyer shumë kampi. Kam takuar shumë shokë dhe shoqe nga pjesë të ndryshme të Kosovës, si nga Prizreni, Mitrovica, Ferizaji dhe qytete tjera të Kosovës,” tha ajo. “Aq sa kemi mësuar nga kampi, kemi mësuar edhe nga njëri-tjetri duke diskutuar për tema të ndryshme shkollore dhe duke ndarë informata mes veti për vendet prej nga vijnë.”

Aktivitetet e përbashkëta me pjesëtarët e

SHPK-së duket se kanë lënë mbresa të pabarueshme në liderët e ardhshëm. “Të jesh në mesin e policëve të SHPK-së do të thotë të jesh në një vend shumë të sigurtë, ku nuk ke frikë prej askujt dhe asgjëje,” thotë një pjesëmarrës tjetër, Arbër Rrustemi nga Mitrovica. “Kemi diskutuar lirshëm me policët e SHPK-së për çështje të ndryshme si psh. për sport, muzikë dhe kemi biseduar shumë për punën e tyre, për gjërat e mira dhe gjërat e këqija që vijnë me këtë punë.”

“Ky kamp ka qenë një mundësi e mirë për të gjithë ne, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, apo prej cilës pjesë të Kosovës vijnë. Ne i kemi shprehur idetë tona se si të zgjidhim probleme të ndryshme në të cilat do të hasim si liderët të ardhshëm,” tha Sevgi. “Kjo poashtu ka treguar se ne mund të shoqërohemi me moshatarët tanë nga komunitetet e ndryshme si me serbë, romë dhe turq që jetojnë në Kosovë. Kjo ka qenë një tregues i mirë se nuk duhet të ketë ndarje në mes të njerëzve të etnive ose besimeve fetare të ndryshme,” shtoi ajo.

Pjesëmarrësit e kampeve ndajnë përvojat e tyre me njerëzit në komunitetet e tyre lokale dhe kjo i bën kampet edhe më unike. “Çdo gjë që kam mësuar këtu do ta ndajë me shokët e mi në qytetin tim të lindjes sepse mendoj që këto janë gjëra shumë të dobishme të cilat do të na ndihmojnë të vazhdojnë jetën tonë drejt së ardhmes,” theksoi Arbëri.

Kampet rinore i dërgojnë këto porosi edhe te zyrtarët e lartë. Ish kryesministri i Kosovës, Bajram Rexhepi, si dhe personalitete ndërkombëtare si shefat e misionit të OSBE-së Fieschi dhe Wnendt kanë vizituar këto kampe gjithashtu.

“Të gjithë ne duhet të jemi qytetarë të Kosovës, sepse nëse Kosova do të ishte një vend monoetnik me siguri do të ishte një vend monoton”, i’u kishte thënë Bajram Rexhepi, ish kryeministër i Kosovës, 120 pjesëmarrësve të Kampit Rinor Liderët e Ardhshëm të mbajtur në qershor të vitit 2004.

“Gjatë kampit rinor të këtij viti ju do të inkurajoheni të konsideroni se cilat janë shpresat tuaja për një të ardhme në Kosovë. A do të jetë një vend i cili ka mësuar nga gabimet e së kaluarës? A do të jetë një vend ku të gjithë qytetarët, pa dallim etnie apo besimi fetar, mund të jetojnë në paqe dhe prosperitet? A do të jetë një vend i cili do të fiton respektin e kombeve tjera si një shoqëri tolerante, e lirë dhe demokratike? Ju i mbani përgjigjet në këto pyetje”.

Këto kanë qenë disa pyetje nga fjalimi mirëseardhës i Stivit që sfiduan pjesëmarrësit e rinjtë. Shpresojmë se këta të rinjtë, si liderët të ardhshëm të Kosovës, do t’i marrin ato në konsiderim.



*Në kampin e të rinjëve liderët e ardhshëm organizuar nga shkolla e SHPK-së, të rinjtë u takuan me udhëheqës politik dhe bënë një komunikim të drejtpërdrejt me ta.*



# Rruga Sesam edukon brezat e rinjë të Kosovës

Një nga serialet më të suksesshme televizive për fëmijë në botë, Rruga Sesam është sjellur në Kosovë në dhjetor të vitit 2004 nga misioni i OSBE-së në Kosovë dhe UNICEF-i. Seriali emetohet nga Radio Televizioni i Kosovës (RTK), i cili mbulon pjesën më të madhe të territorit të Kosovës.

**Mevlyde Salihu, OSBE**

Seriali e 'Rrugës Sesam' kombinojnë arëgëtimin me mësim, dhe i mëson fëmijët për tolerancën dhe respektin e ndërsjellë. 52 epizoda të zgjedhura veçanërisht për Kosovën janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë plotësuar me 26 filma të shkurtër të prodhuar në Kosovë.

RTK-ja e emeton serialin në gjuhën shqipe dhe serbe, 'Rruga Sesam' respektivisht 'Ulica Sezam'. Por, me qëllim që të arrihet më mirë deri tek audienca, seriali në gjuhën serbe emetohet edhe nga DTV-ja, TV Mosti dhe TV Herzi, kanale televizive në gjuhën serbe.

Ideja prapa këtij projekti ka qenë të përhapet një mjet edukativ që e shfrytëzon televizionin si mediumin kryesor, por i cili mund të bëhet edhe pjesë e planprogramit për shkollimin parashkollor dhe klasët e ulëta të shkollës fillore, pasi që fëmijët e moshës parashkollore janë grupmosha kryesore të cilës i dedikohet ky program.

"Qëllimet edukative të këtij programi, të caktuara në mënyrë specifike për Kosovën, ndahen në pesë blloqe," thotë Lucia Elmi, koordinatore e programit pranë zyrës së UNICEF-it në Kosovë.

Sipas saj, blloku i parë kryesor ka të bëjë me shumëllojshmërinë njerëzore. Ky bllok përfshin tema si respektimi i shumëllojshmërisë etnike dhe kulturore, respekti për religjione të ndryshme, barazia gjinore, si dhe respektimi i gjuhëve të ndryshme dhe nevojave të veçanta.

Blloku i dytë ka të bëjë me emocionet njerëzore; lumturinë, pikëllimin dhe hidhërimin, shprehjen e tyre, dhe mundësinë për të ushtruar vetkontroll dhe për ta ruajtur vetbesimin.

Blloku i tretë përqëndrohet në marrëdhëniet shoqërore, miqësinë, ndjeshmërinë, marrjen e vendimeve, kuptimin e të drejtave të njeriut, bashkëpunimin dhe zgjidhjen e konflikteve.

"Blloku i tretë thekson në mënyrë të veçantë shkathhtësitë që janë të domosdoshme për fëmijët nga mosha tri deri në gjashtë vjeç për të zhvilluar marrëdhënie shoqërore," shton Elmi.

Dy blloqet e fundit, blloku i katërt dhe i pestë, adresojnë grupet shoqërore dhe institucionet, shtëpinë, familjen, lagjen, ambientin, si dhe shëndetin dhe ushqimin, vizitat të mjeku dhe parandalimin e sëmundjeve, si dhe mënyrën e shëndoshë të jetuarit.

"Këto janë porositë edukative që i'u dërgohen fëmijëve përmes epizodave të Rrugës Sesam," thotë Elmi.

Për më tepër, filmat e shkurtër të produksionit

vendor adresojnë çështjet që janë specifike për Kosovën, një nga to është përdorimi i gjuhëve të ndryshme, shqipe dhe serbe. Këto pjesë të secilës epizodë i ekspozojnë shikuesit e rinjë ndaj gjuhës së komunitetit tjetër.

Por, edhe pse programi emetohet nga katër stacione televizive, disa rajone malore mbesin pa u mbuluar.

Për të tejkaluar këtë të metë dhe për të transmetuar porositë e tolerancës dhe paqes, si dhe për të ofruar mundësi të barabarta edukimi, misioni i OSBE-së ka filluar një projekt për dërgimin e epizodave të Rrugës Sesam te fëmijët të cilët përndryshe nuk kanë mundësi ta përcjellin.

Fshati Çabër i cili është i banuar me shqiptarë dhe gjendet në komunën e Zubin Potokut, në veri të Kosovës, dhe rajoni i Dragashit në jug të Kosovës, nuk mbulohet nga asnjë nga katër kanalet televizive që e emetojnë Rrugën Sesam.

Zyra e OSBE-së në Mitrovicë ofron përkrahje teknike duke i dërguar kasetat, një video dhe një projektor në shkollën e fshatit Çabër, ku Rruga Sesam shfaqet për fëmijët parashkollorë dhe ata që vijojnë klasët e para të fillores.

Në anën tjetër, në fillim të këtij viti, Qendra për Komunitete në Dragash, e themeluar nga OSBE-ja, ka filluar implementimin e projektit "Kinemaja Lëvizëse", duke e dërguar kështu Rrugën Sesam edhe në fshatrat më të largëta të kësaj komune.

"Fëmijët e kanë mirëpritur këtë iniciativë sepse kjo është mënyra e vetme që ata mund të njihen me programe të ndryshme për fëmijë dhe filma të vizatuar," tha Elvir Ilijazi, koordinataor i projektit në Qendrën për Komunitete në Dragash.

Përderisa programi vazhdon të emetohet nga katër televizionet, siç vazhdon edhe shfaqja në veri dhe jug të Kosovës nga programet e veçanta të OSBE-së, fëmijët e Kosovës vazhdojnë të rriten duke qeshur dhe mësuar me Rrugën Sesam.



Rruga Sesam së shpejti do të shënoj një vjetorin e fillimit të emitimit në Kosovë.

# Ndërtimi i një vizioni të besimit

Ata jetojnë në qytete dhe fshatra afër njëri tjetrit, por rrallë takohen. Janë shqiptarë, kroatë, goranë dhe romë, dhe për shkak të këtij dallimi të vogël por të vetëm, shumë nga këta të rinj nuk arrijnë të njihen mes veti.

**Chris Cycmanick, OSCE**

Zyra e OSBE-së në Lipjan në partneritet me Vizionin e Rinisë, një OJQ nga Janjeva, po bënë përpjekje për t'i afruar këta të rinj, duke i'u ofruar bashkëpunim për një program që do të inkurajonte një bashkëveprim në mes tyre.

Ky lloj aktiviteti është në interes të madh të OSBE-së pasi që reflekton përkushtimin e misionit të OSBE-së në punën që bënë për rithemelimin dhe përmirësimin e marrëdhënjeve mes komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë. Në këtë proces shpeshherë më e rëndësishmja është që të punohet me moshën e re.

Qëllimi kryesor i konceptit ishte të ndihmohej dialogu dhe besimi në një ambient relaxues dhe joformal.

Vizioni i Rinisë, i themeluar në vitin 2001, ishte zgjedhur si partner implementues i OSBE-së në rajon pasi që puna e tyre është fokusuar kryesisht në aktivitetet rinore për të gjitha etnicitetet, duke përfshirë seminare për fëmijë parashkollor, trajnime për mësimin e kompjuterit, kurse të gjuhës, udhëtime në terren për të rinjë.

Programi gjashtë mujor, i cili përfundoi në prill të vitit 2005, ka përfshirë fëmijët e zgjedhur të moshës nga 13 deri në 15 vjeçare që së bashku të marrin pjesë në një varg mësimesh për artin në shkollat në Janjevë, Lipjan dhe Aklap. Grupet, që përafësisht përbëjnë 15 persona, takohen tri herë në javë, dy orë në javë pasdite dhe gjatë vikendeve.

Ramiz Gashi, udhëheqës i Vizionit të Rinisë dhe drejtor i projektit, ishte mjaft i kënaqur me rezultatet e iniciativës.

"Tsha i befasuar me gjithë atë talent që e pashë, sidomos mënyra si bashkëpunonin fëmijët. Natyrisht që ata ishin të komuniteteve të ndryshme dhe flisnin gjuhë të ndryshme, por kjo nuk paraqiste ndonjë problem. Fëmijët shpeshë komunikonin përmes gjeesteve dhe për ta ishte diçka zbatimëse kur mësonin fjalë dhe fraza në gjuhë të reja," tregon Gashi.

Pjesa më interesante për fëmijë ishte ekspozita e artit e mbajtur në fund të kursit dhe e ndjekur nga anëtarët e secilit komunitet përkatës. Në ekspozitë mund të shihje vizatimet e fëmijëve, pikturat, dhe punime prej druri.

Rezultatet afatgjata të programit ende nuk janë përcaktuar, por është një hap në drejtim të drejtë në ndërtimin e besimit dhe të kthimit në një shoqëri të re të atyre që mund të kenë qenë të huaj.

# DUKE PUNUAR PËR TË MIRËN E QYTETARËVE

Artikuj të shkruar nga Radka Betcheva, në bashkëpunim me Xhozef Flood, Silvia Eckert, Alan Skurbaty, Jade Duchesneau-Bernier, Ljubiša Simić, Shpëtim Mustafa dhe Nikola Gaon

## Nga zyra e OSBE-së në Gjilan

“Asnjë nga ne nuk është aq i mençur sa të gjithë ne së bashku,” thotë Xhozef Flud, shef i zyrës së OSBE-së në Gjilan. Ai çdo ditë ua përkujton këto fjalë 57 punëtorëve të zyrës së OSBE-së në Gjilan dhe se kjo është ideja e tij bazë prapa stilit të tij menaxhues.

Zyra e OSBE-së në Gjilan është njëra nga të tre zyrat e OSBE-së në Kosovë. Fryma e punës ekipore këtu është e fuqishme. Z. Flud, ose Papa Xho (nga emri Xhozef) siç e thërresin punëtorët, thotë se është krenar me stafin e tij. Sipas tij, ata janë të gatshëm ta pranojnë individualitetin e njëri-tjetrit dhe të njerëzve që ata takojnë përmes punës, dhe çmojnë lartë këtë shumëllojshmëri. Përveç stafit vendor, shqiptarë, serbë dhe boshnjakë të Kosovës, në zyrën e Gjilanit punojnë edhe ndërkomëtarë nga nëntë shtete të ndryshme.

Punëtorët e kësaj zyre punojnë për të mirën e popullatës vendore. “Ne punojmë për të mirën e njerëzve të cilëve i’u shërbejmë,” thotë z. Flud. Kjo duket të jetë forca shtytëse prapa motivimit të lartë të njerëzve në zyrën e tij.

Z. Fludi thotë se është me rëndësi të projektohet me efekt imazhi i OSBE-së si një partner i besueshëm, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë, si dhe të merret parasysh puna si

tërësi e misionit të OSBE-së dhe prioritetet e saj në terren.

Derisa mandati i përgjithshëm i misionit të OSBE-së në Kosovë, si shtyllë e tretë e UNMIK-ut është ndërtimi i institucioneve dhe demokracisë si dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, misioni tani është duke u përqëndruar edhe në dhënie të ndihmës dhe monitorimin e implementimit të standardeve për Kosovën.

Kështu, zyra e OSBE-së në Gjilan është duke ndihmuar në fuqizimin dhe zhvillimin e kuadrove dhe lidhshiptit vendor, OJQ-ve, organizatave të mediave dhe shoqatave të qytetarëve. Poashtu punon intenzivisht edhe me rininë. Krejt kjo bëhet me qëllim që t’i ndihmohet Kosovës për t’u zhvilluar si shoqëri demokratike ku respektohen të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit.

“Të punosh për këto çështje me një rëndësi afatgjatë është sikur të mbjellësh fara,” thotë z. Flud. “Rezultatet e menjëhershme nuk

mund të shihen dhe nevojitet kohë për të pasur frytë.”

Sidoqoftë, z. Flud është shumë optimist dhe thotë se suksesi i zyrës së Gjilanit do të matet përmes mënyrës se si njerëzit e të gjitha komuniteteve në rajonin e Gjilanit e shohin ardhmërinë e tyre. “Shpresoj se ata do të fillojnë të shohin pamjen më të madhe dhe do të vendosin të punojnë së bashku ashtu si ndoshta kurrë më parë.”

Një nxitje për popullatën dhe autoritetet lokale për ta bërë këtë tani është e mishëruar në shpërblimin e Këshillit të Evropës të cilin e ka fituar Gjilani duke u zgjedhur si Komuna më e mirë në maj të vitit 2005. Duke qenë e vetmja komunë në Kosovë që ka fituar një shpërblim të tillë për promovimin e vlerave evropiane, Gjilanin e presin akoma shumë punë.

Papa Xho dhe ekipi i tij janë aty për të ndihmuar.



Zyra e OSBE-së në Gjilan mbanë raporte të afërta me popullatën lokale. Drejtori i zyrës Xhozef Flud (në mes), siguron se do të angazhohet në të gjitha aktivitetet e zyrës. Ai shprehet i lumtur me rastin e ndarjes së diplomave gazetarëve të diplomuarve nga trajnimi.



# Promovohet barazia gjinore

Barazia gjinore si koncept bazohet në parimin se çdo qenie njerëzore duhet të respektohet dhe trajtohet në mënyrë të barabartë. Në anën tjetër, shumë shoqëri 'tradicionale' i vendosin meshkujt në pozitë të fuqisë, ndikimit dhe autoritetit dhe i lënë femrave në pozitë që të pajtohen me atë që meshkujt thonë.

Kjo shpesh ndodh në Kosovë. Tregues i mirë është numri shumë i vogël e femrave aktive në politikë apo në jetën shoqërore.

Duke promovuar respektimin e të drejtave të njeriut, misioni i OSBE-së në Kosovë promovon edhe barazinë gjinore. Aktualisht në nivelin lokal, zyra e OSBE-së në Gjilan përkrah punën e zyrtarit komunal për çështje gjinore.

Kjo përkrahje daton nga fillimi i vitit 2005 kur zyra e OSBE-së ka filluar të llojë me kryeshefin ekzekutiv të Komunës për të krijuar pozitën e zyrtarit për çështje gjinore.

Kjo pozitë u krijua në prill të këtij viti. Gjatë pesë muajve të fundit, zyra e OSBE-së ka ofruar disa trajnime për zyrtarët për çështje gjinore, të cilët tani punojnë për të siguruar se parimet e barazisë gjinore respektohen në komunën e Gjilanit. Krijimi i mundësive të barabarta për punësim është sigursisht prioriteti më i lartë.

Duke përkrahur më tutje punën e këtyre zyrtarëve, OSBE-ja ka organizuar trajnime për të drejtat e njeriut për shërbyesit civil. Dy konferenca mbi barazinë gjinore që janë organizuar këtë vit kanë çuar në ndryshime të rregulloreve komunale që sigurojnë pozitë të barabartë për gjininë femrore në komunë.

Fatushe Haliti, zyrtare komunale për bashkëpunim dhe koordinim, në një letër falenderimi për zyren e OSBE-së shkruan: "Ne kemi shkëmbyer informata dhe kemi shfrytëzuar mundësinë për të përfitur nga ekspertiza për të drejtat e njeriut që ju e keni ofruar. Ne kemi përmirësuar të metat në ligje dhe kemi përmirësuar proceset tona vendimarrëse."

Në të njëjtën kohë me qëllim që të ndihmon në ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e barazisë gjinore brenda komunës, zyra e OSBE-së është duke adresuar çështjen e dhunës familjare, një çështje e pranishme në mbarë botën, por më shpesh në shoqëritë ku femrat janë tradicionalisht të nënshtruara ndaj meshkujve.

Duke punuar me zyrtarin komunal për çështje gjinore, në maj të këtij viti OSBE-ja ka filluar një fushatë informative rajonale për të ngritur vetëdijen për dhunën në familje dhe efektet e saj. Cak i fushatës janë nxënësit e shkollave të mesme, në veçanti femrat e reja. Aktivitetet e fushatës kanë filluar në maj të këtij viti me trajnimin e trajnuesve, zyrtarëve komunal për çështje gjinore nga rajoni i Gjilanit dhe zyrtarë policorë të cilët pastaj nëpër shkolla kanë organizuar seminare në lidhje me dhunën në familje.

Ramadan Avdyli, pjesëtar i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK), pasi kishte ndjekur një nga këto seminare tha, "duke qenë në gjendje të bashkëpunojnë drejtpërdrejt me zyrtarë policorë të SHPK-së në mënyrë shoqërore dhe joformale, të rinjtë do të kenë më pak paragjykim dhe do të jenë më të prirur t'i qasen policisë në të ardhmen. Çështja e dhunës në familje tërheq vëmendjen e nxënësve dhe këtë duhet ta përdorim për qëllim të mirë".

Faza e dytë e projektit tani planifikohet të fillojë kah mesi i shtatorit të vitit 2005 dhe trajnuesit duhet të organizojnë 320 seminare për nxënësit e shkollave të mesme në Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Viti. Projekti do të përfundojë me një dokument të hartuar për të vënë në pah nevojat e identifikuara nga trajnuesit dhe rekomandimet për komunat dhe autoritetet e nivelit qëndror për mënyrat dhe

mjetet për adresimin e këtyre nevojave.

Sipas Jade Duchesneau-Bernier, zyrtar për demokratizim në zyren e Gjilanit, fushata i'u ka dhënë zyrtarëve komunal për çështje gjinore një mundësi për të qenë aktivisht të angazhuar në një çështje që ata e konsiderojnë si të rëndësishme dhe për të zhvilluar kapacitetet e tyre në fushën e koordinimit të projektit dhe menaxhimit.

## Angazhimi i rinisë në politikë

Popullata e Kosovës është e moshës shumë të re. Mbi 60% janë nën moshën 26 dhe rreth 70% janë nën 35 vjeçare. Duke e pasur parasysh se një person mund të votoj kur ajo/ai arrin moshën 18 vjeç, mund të thuhet se rinia mund të bëjë dhe të tejkaloj zgjedhjet nëse është politikisht aktive.

Për të zhvilluar kapacitetin e të rinjve që të përfshihen në jetën politike misioni i OSBE-së ka filluar të implementoj projektin e quajtur Kuvendet Rinore. Qëllimi i këtij projekti është që të përfshijë rinin në procesin e vendimarrjes në nivelin lokal dhe qëndror.

Por për t'u angazhuar në mënyrë aktive në jetën politike rinia së pari duhet të mësojë për sistemin politik ku ata jetojnë. Kuvendet Rinore janë duke e bërë këtë. Në takimet e tyre të rinjtë e stimulojnë punën e Kuvendëve komunale, apo punën e organeve arsimore dhe politike. Përmes këtyre stimulimeve ata mësojnë se si t'i zgjidhin problemet e vërteta në jetë.

Edhe pse rezultate të menjëhershme nuk mund të shihen përvojat prej shumë vendeve në tranzicion tregojnë se të rinjtë të cilët kanë marrë pjesë në aktivitetet të ngjashme janë bërë një forcë shtytëse për ndryshime pozitive.

Silvia Eckert, Udhëheqëse e Ekipit për Demokratizim në zyren e OSBE-së në Gjilan beson se lidhshipi i së nesërme në Kosovë do të zgjedhet prej rinisë së sotme të Kosovës. "Aktivitetet e misionit të cilat përfshijnë rininë u ofrojnë atyre një mundësi që të zhvillohen dhe të përfshihen në proceset e vendimarrjes, si dhe të kompensojnë në mungesë të gjuhës së përbashkët që shumë shpesh u mungon të rinjve prej komuniteteve të ndryshme."

Zyra e OSBE-së në Gjilan i ka zhvilluar disa trajnime për anëtarët e Kuvendit Rinor që kanë patur të bëjnë me temat siç janë përbërja dhe struktura e komunave si dhe menaxhimi i efektshëm i mbledhjeve.

Për ta ndihmuar edhe më tepër Kuvendin Rinor, zyra e OSBE-së u ofron atyre edhe trajnime në hartimin dhe implementimin e projekteve të ndryshme. Si rezultat, Kuvendi Rinor në Gjilan ka organizuar një numër të garave sportive si dhe kremtimin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Në një përpjekje për të dhënë një ndikim të drejtpërdrejt në shoqëri, Kuvendi Rinor mblodhi shumë organizata rinore dhe promovoi vetë-

niciativë dhe angazhim më aktiv të rinisë në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe politike në Kosovë.

"Unë takova shumë njerëz me përkatësi etnike të ndryshme nga e tërë Kosova, dhe jam i lumtur të them se shumë prej tyre i kam bërë shokë," tha Milosh Jovanović, një pjesëtar Serb anëtar i Kuvendit Rinor në Gjilan. "Pjesëmarrja në një produksion dokumentar, sponsoruar nga OSBE-ja, i cili trajton çështjen e lëvizjes së lirë, unë fitova një njohuri të dobishme të cilën mund ta shfrytëzoj në jetën time të përditshme", shtoi ai. Miloshi si i ri pati rastin të bashkëpunojë me shumë OJQ dhe përfundimisht të përfshihet në aktivitetet e tyre. "Në përgjithësi, më duhet të pranoj se jam shumë i lumtur që jam anëtar i Kuvendit Rinor në Gjilan", përfundoi ai.

Një përpjekje shtesë e OSBE-së që të ndihmojë rininë të përfitoj një eksperiencë të vlefshme me funksionimin e institucioneve demokratike dhe monitorimin e punës së tyre që të jet në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, është themeluar Grupi Rinor i të Drejtave të Njeriut (GRDN). Në Gjilan, ky projekt ka filluar në vitin 2001 me qëllim të ngritjes dhe të promovimit të vetëdijës për të drejtat e njeriut mes të rinjve. GRDN-ja përbëhet prej 17 anëtarëve të rinjë, nxënës të shkollave të mesme të qytetit të Gjilanit.

GRDN-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm në themelimin e një rrjeti të gjerë të Klubeve për të Drejtat e Njeriut në tërë Kosovën. Ata kanë kryer një numër të aktivitetëve në ngritjen e vetëdijës për të drejtat e njeriut në shkollat e tyre por edhe në shoqëri në tërësi. Lirije Maliqi, nga GRDN-ja në Gjilan thotë se të jesh anëtare e grupit të të drejtave të njeriut është një rast jashtëzakonisht i mirë për të mësuar dhe për përjetuar vlerat demokratike në jetën tonë të tanishme në Kosovë.

Për Lirijen dhe anëtarët tjerë të grupeve rinore në Gjilan dhe në qytetet tjera të Kosovës, Klubet për të Drejtat e Njeriut janë një mjet i efektshëm për t'i paraqitur ndryshimet në shoqëri.

# Ofrimi i informatave të nevojshme

**Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptase (RAE) janë ndër grupet më të dëmtuara në Kosovë. Niveli i tyre i integritimit në shoqëri është shumë i ulët, gjë që rezulton me rrjedhë të dobët të informatave nga dhe për këto komunitete.**

Në përpjekje për ta thyer këtë bllokadë informative dhe për të ndihmuar në ngritjen e nivelit të integritimit të tyre në shoqëri, zyra e OSBE-së në Gjilan është përfshirë në disa projekte të cilat çojnë drejt fuqizimit të medieve të RAE dhe një rritje në programin televiziv në gjuhën rome.

Një projekt për themelimin e redaksisë rome në stacionin lokal televiziv TV ZOOM ka filluar në korrik të këtij viti. Nën këtë projekt, një orë program në gjuhën rome do të përgatitet dhe do të ofron informatave për çështjet që janë prioritet për ta, si shkollimi, punësimi, mbrojtja shëndetësore e kështu me radhë. Programet do të përgatiten nga një grup prej gjashtë gazetarëve të rinj romë të cilët dëshirojnë të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes së komunitetit të tyre.

Gjatë vitit 2004, grupi i njëjtë në bashkëpunim me TV ZOOM-in, ka përgatitur nëntë filma dokumentarë për jetën e romëve në Kosovë. Transmetuesi public, RTK-ja, ka emetuar një nga këta filma si pjesë e një programi televiziv të dedikuar romëve.

Për të ndihmuar në zhvillimin e tyre profesional, zyra e OSBE-së ka ofruar disa trajnime për media dhe ka organizuar vizita në redaksi tjera rome për të ndihmuar themelimin e një rrjeti të gazetarëve.

Zecie Demiri, gazetar rom është i bindur se

themelimi i redaksisë rome në një televizion lokal është një hap shumë inkurajues drejt mbrojtjes së identitetit të romëve. "Komuniteti rom ka qenë i privuar nga informimi në gjuhën e tyre, në veçanti pas fillimit të konfliktit në vitin 1999. Dëshira jonë më e madhe është t'i ofrojmë komunitetit rom informata të detajuara të rëndësishme për jetën tonë të përditshme dhe për të nxitur procesin e kthimit të romëve," tha ai.

Para fillimit të bashkëpunimit me TV ZOOM-in, zyra e OSBE-së në Gjilan në vitin 2004 ka filluar përkrahjen botimor e 'Romani Rota', gazetë në gjuhën rome. Si një mjet për shpërndarjen e informatave të romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit, kjo gazetë mbulon tema siç janë çështjet komunale, procesi i kthimit, takimet e komuniteteve RAE dhe aktivitetet e tyre shoqërore. Gazeta del një herë në muaj ku shpërndahet dhe mbulon Gjilanin, Kamenicën, Novobërdën dhe Vitinë.

Redaktorët e 'Romani Rotës' janë edhe koordinatorët të Qendrës për Edukim Civil (QEC), e cila është hapur në Gjilan në shkurt të vitit 2003, si pjesë e Rrjetës Avokuese të RAE, projekt i udhëhequr nga misioni i OSBE-së.

QEC-i organizon mbledhje çdo dy javë në mes të agjencioneve ndërkombëtare, udhëheqes së RAE-s dhe pjesëtarëve të komuniteteve. Qëllimi i tyre është të shkëm-

bejnë informata për projektet në vazhdim e sipër dhe çështjet që janë brengosëse për komunitetet. Problemet si papunësia, kushtet e rënda sociale dhe diskriminimi i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasëve në tregun e punës diskutohen shpesh në këto takime. Këto çështje problematike janë sjellë në vëmendjen e organeve vendimarrëse në nivelin komunal.

Tërë këta mekanizma për shkëmbim të informatave janë duke e ndihmuar themelimin e një bashkëpunimi më të mirë në mes të autoriteteve lokale dhe komuniteteve të RAE-as.

Ndihma e mëtutjeshme i integron këto komunitete dhe pakicat tjera në shoqëri. Zyra e OSBE-së ka punuar me zyrтарin komunal për komunitete në Gjilan për të përfshirë një rom dhe një turk në punën e zyrës. Që të dy janë bërë anëtarë të stafit. Rekomandimi i njëjtë i është bërë autoriteteve komunale dhe janë pajtuar se vitin e ardhshëm, pra në vitin 2006, lista e të punësuarve të komunës do të jetë më e balancuar dhe në proporcion me numrin ekzistues etnik.

Mbetet të shpresohet se shkëmbimi i vazhdueshëm i informatave dhe përpjekjet e koordinuara të komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptase dhe autoriteteve komunale do të krijojnë kualitet më të mirë të jetës për të gjithë banorët e regjionit të Gjilanit.

## Krijimi i mediave përgjegjëse dhe profesionale

**Mjetet e komunikimit masiv në ditët e sotme luajnë një rol të madh në formimin e opinionit publik. Shumë procese shoqërore, poqëse mbështeten nga mediat, mund të ndodhin shumë më shpejtë. Tek ne, këto procese mund të vështrohen nga niveli i implementimit të standardeve për Kosovën.**

Mediat i shërbejnë publikut më së miri kur ato sillen në mënyrë profesionale, respektivisht kodin e mirësjelljes për mediat dhe arrijnë shkallën e vetqëndrueshmërisë që do të thotë se janë të lira nga ndikimet politike apo çfardo ndikimi tjetër. Zyra e OSBE-së në Gjilan po i ndihmon mediat lokale në të gjitha këto fusha.

Në janar të vitit 2005 misioni i OSBE-së në Kosovë ka filluar me implementimin e projektit 'Rrjeti i Mediave Lokale', që përbëhet nga tri lloj aktivitetesh: asistenca në këshilldhënje, asistenca teorike dhe asistenca praktike.

Zyrtarja e lartë për demokratizimin e mediave pranë zyrës së OSBE-së në Gjilan Radka Betcheva, u ofron asistencë profesionale mediave lokale për çështjet që ata i shqetësojnë në punën e tyre të përditshme. Ajo organizon takime të rregullta me udhëheqës dhe gazetar të mediave në regjion dhe diskutojnë për operacionet e tyre. Me identifikimin e fushave në të cilat ata kanë nevojë për përmirësim ata organizojnë trajnime dhe takime me institucionet lokale.

Shyqeri Halabaku, redaktor në radion "Zëri i Pozheranit" tha se takimet dhe trajnimet e organizuara nga zyra e OSBE-së në Gjilan kanë kontribuar shumë në përmirësimin e raporteve në mes të gazetarëve dhe institucioneve vendore si policinë, korporatën energjetike si dhe kompaninë e posteve. "Një shembull për ta ilustruar këtë është se për herë të parë, zyrtarët e SHPK-së diskutuan hapur për mundësinë e bashkëpunimit në mes të policisë dhe mediave".

Projekti i rrjetit të mediave lokale gjithashtu përfshin punëtori të ndryshme, bashkëpunimin e radio dhe TV programeve dhe reklameve, organizimin e konkurseve me karakter garues për artikullin më të mirë gazetaresk, e kështu me radhë. Këto aktivitete ndihmojnë në krijimin e një atmosfere të mirë bashkëpunimi dhe lidhje në mes të mediave lokale. Sipas z. Betcheva, krijimi i lidhjeve dhe partneritetit në mes të mediave lokale do t'i ndihmonte ata të përgatisin programe me karakter konkures por edhe të mbijetojnë në një treg të stërngarkuar medial.



*Sjellja profesionale dhe me përgjegjësi e mediave është çelës i zhvillimit demokratik në nivelin lokal. Përmes trajnimeve dhe konsultimeve, zyra e OSBE-së në Gjilan u ndihmon mediave lokale në krijimin dhe ruajtjen e principeve të tilla.*